

L I G J
Nr.8445, datë 21.1.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8070,
DATË 15.2.1996; NR.8126, DATË 9.7.1996; NR.8130, DATË 22.7.1996; NR.8149, DATË
11.9.1996; NR.8160, DATË 7.11.1996; NR.8186, DATË 23.1.1997; NR.8201, DATË
20.3.1997; NR.8140, DATË 16.9.1997

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", ndryshuar me ligjet nr.8070, datë 15.2.1996; nr.8126, datë 9.7.1996; nr.8130, datë 22.7.1996; nr.8149, datë 11.9.1996; nr.8160, datë 7.11.1996; nr.8186, datë 23.1.1997; nr.8201, datë 20.3.1997; nr.8140, datë 16.9.1997; neni 36 pika 2 ndryshohet si vijon:

"Për qëllimet e këtij ligji, fatura hartohet në formën e caktuar nga ministri i Financave dhe përmban:

- a. Emrin, adresën, NIPT- në dhe kodin fiskal të personit që bën furnizimin;
- b. emrin, adresën dhe NIPT- në, së bashku me kodin fiskal për blerësin person i tatueshëm i regjistruar për TVSH, emrin, adresën dhe kodin fiskal për blerësin person i tatueshëm i biznesit të vogël dhe vetëm emrin e adresën për blerësit persona të tjerë;
- c. datën në të cilën lëshohet fatura;
- ç. numrin e serisë së vendosur nga shtypshkronja që e ka shtypur;
- d. numrin rendor;
- dh. përshkrimin e çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar;
- e. sasinë e mallrave apo madhësinë e shërbimeve të furnizuara;
- ç. çmimin për njësi, pa TVSH- në, për çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar, duke përfshirë çdo ulje;
- f. shumën e pagueshme pa TVSH- në;
- g. përqindjen e TVSH- së së pagueshme ndaj çdo lloj malli apo shërbimi të furnizuar;
- gj. shumën e TVSH- së së pagueshme;
- h. shumën e pagueshme me TVSH;
- i. çdo të dhënë tjetër që kërkohet nga ministri i Financave.

Neni 2

Ngarkohet Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për prodhimin e faturës tatimore sipas këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2304, datë 1.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**